



A K T T H E M E L U E S

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“R A T I” SH.P.K.

Une Arif Ah, i biri i Muratit, dtl. 30.05.1961, banues Rruga “Komuna e Parisit”, Selite, Tirane, mbeshtetur ne Ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit ”, te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, “ Per shoqerite tregtare ” dhe te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, “ Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare ”, krijoj shoqerine tregtare private me perjegjesi te kufizuar “ R A T I ” dhe me aktin themelues te saj si vijon :

F O R M I M I

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur “ R A T I ” sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise tregtare private “ R A T I ” sh.p.k. do te jete : Rruga “Komuna e Parisit”, Selite, Tirane.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e :

1- Projektimit te ndertimeve

Kat. 3 a - Objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

b - Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kate – objekte me skelet metalik.

Kat. 6 a- Rrugë auto kategoria V dhe VI.

Kat. 7 a- Ura dhe vepra arti të vogla deri në 10 m.

2- Zbatimit te punimeve te ndertimit.

- Kat. 1 Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme. Prishje dhe punime ne toke te germuar.
- Kat. 2 a Prodhim materiale inerte – gure.
c Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshem – paranderur – gure dekorative.
- Kat. 3 a Ndertime civile – industriale – turistike – bujzesore deri 5 kate.
b Ndertime civile – industriale – turistike – bujzesore mbi 5 kate – Rikonstrukione.
c Ndertime banese me skelet mbi 8 kate.
- Kat. 4 a Ndertime rruge kategoria V dhe IV.
c Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore.
- Kat. 6 a Ndertim ura dhe vepra arti deri ne dhjete metra.
b Ndertim ura dhe vepra arti mbi dhjete metra – estakada – ura metalike – te varura.
- Kat. 8 b Ndertime ujesjellsa dhe kanalizime, kanale e impiante vaditese.
e Ndertim diga – damba deri 10m.
- Kat. 9 a Sillosa, kulla, kulla uji etj.prej b/arne e metalike.
b Perforcim themeli e punime nentokesore.
- Kat.11 a Punime karpentierie druri.
b Punime karpentierie metalike.
- Kat.14 b Pastrim i siperfaqes urbane.
c Kryerja e punimeve ne sherbesa funerale
d Mirëmbajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane, ndriçimi dhe sinjalizimi urban.
- 3- Prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit me shumice e pakice, import – eksport.
- 4- Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te:
mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro-sanitare, hidraulike, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro - shtepiake, pjese kembimi per automjete, produkte bujzesore e blegtore, fruta perime, produkte te detit, bime medicinale eterovajore e mjeksore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente.
- 5- Transport mallrash brenda e jashte vendit.

NENI 4

Per kryerjen e veprimitarise se saj shoqeria do te hape objekte e njesi sherbimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQUERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkaku.

KAPITALI I SHOQUERISE

NENI 6

Kapitali fillestari i shoquerise tregtare private “**R A T I**” sh.p.k. do te jete 100.000 leke. dhe do te perbehet nga kuota e ortakut themelues te shoquerise.

Kapitali fillestari mund te shtohet sipas vendimit te ortakut themelues. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaku i vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoquerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demtoje interesat e personave te tjere dhe te shoquerise.

DREJTIMI I SHOQUERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, z. **Arif Alla**, i cili eshte edhe perfaqesuesi ligor i saj.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoquerise i takojne ortakut themelues te shoquerise.

NENI 10

Ortaku themelues ka te drejte te emeroje edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoquerise. Ai ka te drejte te caktoje financier, likuidator per problemet e shoquerise, si edhe te pajtojne persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoquerise.

NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykojen dhe zgjidhen ne zbatim te legjisacionit shqiptar ne gjykaten e Rrethit Gyqesor Tirane.

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakoneshme, me tekstin per rrethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plete te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992
“ Mbi krijimin e shoqerive tregtare ”.

NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

NENI 15

Akti i themelimit, u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente
dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private
“ R A T I ” sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“ R A T I ” sh.p.k.

Arif Alla



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“RATI”

Ne baze te ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit ”, te ligji Nr.7638 date 19.11.1992, “ Per shoqerite tregtare ”, dhe te Ligji Nr.7667, date 28.01.1993 “ Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare ”, me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues :

Une Arif Alla, i biri i Muratit, dtl. 30.05.1961, banues Rruga “Komuna e Parisit”, Selite, Tirane, hartoj Statutin e shoqerise si me poshte :

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emertohet “ R A T I ” sh.p.k.

NENI 2

Selia e shoqerise tregtare private “ R A T I ” sh.p.k. do te jete : Rruga “Komuna e Parisit”, Selite, Tirane.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregtar, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e :

1- Projektimit te ndertimeve

Kat. 3 a - Objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

b - Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kate – objekte me skelet metalik.

Kat. 6 a- Rrugë auto kategoria V dhe VI.

Kat. 7 a- Ura dhe vepra arti të vogla deri në 10 m.

2- Zbatimit te punimeve te ndertimit.

- Kat. 1 Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme. Prishje dhe punime ne toke te germuar.
- Kat. 2 a Prodhim materiale inerte – gure.
c Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshem – paranderur – gure dekorative.
- Kat. 3 a Ndertime civile – industriale – turistike – bujzesore deri 5 kate.
b Ndertime civile – industriale – turistike – bujzesore mbi 5 kate – Rikonstruksione.
c Ndertime banese me skelet mbi 8 kate.
- Kat. 4 a Ndertime rruge kategoria V dhe IV.
c Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore.
- Kat. 6 a Ndertim ura dhe vepra arti deri ne dhjete metra.
b Ndertim ura dhe vepra arti mbi dhjete metra – estakada – ura metalike – te varura.
- Kat. 8 b Ndertime ujesjellsa dhe kanalizime, kanale e impiante vaditese.
e Ndertim diga – damba deri 10m.
- Kat. 9 a Sillosa, kulla, kulla uji etj.prej b/arne e metalike.
b Perforcim themeli e punime nentokesore.
- Kat. 11 a Punime karpentierie druri.
b Punime karpentierie metalike.
- Kat. 14 b Pastrim i siperaqes urbane.
c Kryerja e punimeve ne sherbesa funerale
d Mirëmbajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane, ndriçimi dhe sinjalizimi urban.
- 3- Prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit me shumice e pakice, import – eksport.
- 4- Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te:
mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro-sanitare, hidraulike, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro - shtepiake, pjese kembimi per automjete, produkte bujzesore e blegtore, fruta perime, produkte te detit, bime medicinale eterovajore e mjeksore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente.
- 5- Transport mallrash brenda e jashte vendit.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare private “ R A T I ” sh.p.k. do te jetë 100.000 leke. Kapitali fillestari i shoqerise mund te ndryshohet, te shtohet, sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 6

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujteshme ose te palujteshme etj, te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 7

Kuota e kapitalit fillestar sigurohet nga ortaku themelues dhe eshte i regjistruar ne librin e llogarise te shoqerise.

NENI 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerjen e bilanceve periodike, i takojne ortakut themelues, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

NENI 9

Shoqeria tregtare “**R A T I**” sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria tregtare “**R A T I**” sh.p.k. gezon te drejta, sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 10

Shoqeria tregtare “**R A T I**” sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku themelues i shoqerise mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 11

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, z. **Arif Alla**, i cili eshte edhe perfaqesuesi ligjor i saj.

NENI 12

Hyjne brenda detyrave dhe kopetencave te ortakut themelues si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarise vjetore.

3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise.
8. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

NENI 13

Administratori jo ortak perveç detyrave qe i cakton ortaku themelues i shoqerise ka edhe keto detyra e te drejta :

1. Te mire-administroje pasurine e shoqerise.
2. Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortaku themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
4. Te per gjigjet per demet qe i sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marreveshjes te bere me ortakun themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithcka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 14

Shoqeria ka te drejte :

1. Te kryej veprimitari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punonjes te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 15

Shoqeria ka per detyre :

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.
3. Te siguroje punonjesit e saj.

4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 16

E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 17

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni finanziar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

NENI 18

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 19

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjate vitit finanziar, shoqeria, pasi ben zbritjet e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5 % te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", deri sa ky fond te arrije ne masen 10 % te kapitalit themeltar.

NENI 21

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondev te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdonim ortakut themelues te shoqerise.

Konvertimi i parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shtetit shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

DISPOZITA TE VECANTA

NENI 22

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 23

Shndrrimi i shoqerise “**R A T I**” sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te ortakut themelues.

NENI 24

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese se ortakeve. (Ortaku i vetem themelues).

Ne keto raste, pronari i shoqerise vendos mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

Likuidatori eshte pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik e juridik, duke likuiduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.

Ne rast se fontlet disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe i takojne atij.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 25

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaku themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen me menyren dhe proceduren me te cilin nxirret vete statuti.

NENI 26

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private “**R A T I**” sh.p.k.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“**R A T I**” sh.p.k.

Arif Alla

